


Aksidentet Rrugore

Dhjetor 2022

Tiranë, më 18 Janar 2023: Në muajin Dhjetor 2022 numërohen 105 aksidente rrugore nga 119 të ndodhura në muajin Dhjetor 2021. Numri i aksidenteve rrugore është ulur me 11,8 %.

Fig. 1 Aksidentet rrugore dhe të aksidentuarit (të vrarë e të plagosur), Dhjetor 2018 – Dhjetor 2022



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Numri i të aksidentuarve (të vrarë dhe të plagosur) rezulton 120 persona nga 134 në muajin Dhjetor 2021.

Aksidentet rrugore, në 79,0 % të rasteve, kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së drejtuesit të mjetit. Numri më i lartë i aksidenteve në këtë periudhë është kryer nga grup-mosha 25-34 vjeç, duke zënë 28,6 % të numrit të aksidenteve gjithsej. Numri i aksidenteve rrugore për këtë grup-moshë është i njëjtë me numrin e aksidenteve rrugore në Dhjetor 2021.

Në vitin 2022, numërohen 1.165 aksidente rrugore nga 1.376 aksidente, të ndodhura në vitin 2021. Numri i aksidenteve rrugore është ulur me 15,3 %.

Numri i të aksidentuarve është 1.599 persona nga 1.860 persona të aksidentuar në vitin 2021.

Aksidentet rrugore, në 14,3 % të rasteve, në vitin 2022 kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së këmbësorit. Numri i aksidenteve sipas sjelljes së këmbësorit është ulur me 20,5 %.

Tab. 1 Aksidentet rrugore dhe numri i të aksidentuarve sipas gjinisë

Periudha	Aksidente		Të vdekur dhe të plagosur	
	Gjithsej	Femra	Meshkuj	
Dhjetor 2021	119	37	97	
Dhjetor 2022	105	30	90	
Ndryshimi vjetor (%)	-11,8	-18,9	-7,2	
Janar-Dhjetor 2021	1.376	580	1.280	
Janar-Dhjetor 2022	1.165	509	1.090	
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	-15,3	-12,2	-14,8	

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Tab. 2 Aksidentet rrugore sipas përdoruesve të rrugës

Periudha	Aksidentet sipas		Të vdekur dhe të plagosur	
	Sjellja e drejtuesit të mjetit	Sjellja e këmbësorit	Sjellja e drejtuesit të mjetit	Sjellja e këmbësorit
Dhjetor 2021	102	17	117	17
Dhjetor 2022	83	22	96	24
Ndryshimi vjetor (%)	-18,6	29,4	-17,9	41,2
Janar-Dhjetor 2021	1.166	210	1.640	220
Janar-Dhjetor 2022	998	167	1.421	178
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	-14,4	-20,5	-13,4	-19,1

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Tab. 3 Aksidentet rrugore sipas moshës së drejtuesit të mjetit

Periudha	0 - 24 vjeç	25- 34 vjeç	35- 44 vjeç	45-59 vjeç	60+ vjeç	Larguar nga vendi i ngjarjes
Dhjetor 2021	20	30	25	21	11	12
Dhjetor 2022	19	30	13	27	10	6
Ndryshimi vjetor (%)	-5,0	0,0	-48,0	28,6	-9,1	-50,0
Janar-Dhjetor 2021	291	371	251	247	129	87
Janar-Dhjetor 2022	218	322	213	229	123	60
Ndryshimi vjetor progresiv %	-25,1	-13,2	-15,1	-7,3	-4,7	-31,0

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Tab. 4 Aksidentet rrugore dhe numri i të vdekurve sipas qarqeve

Periudha	Aksidente		Të vdekur dhe të plagosur		Aksidente		Të vdekur dhe të plagosur	
	Dhjetor 2021	Dhjetor 2022	Dhjetor 2021	Dhjetor 2022	Janar-Dhjetor 2021	Janar-Dhjetor 2022	Janar-Dhjetor 2021	Janar-Dhjetor 2022
Shqipëria	119	105	134	120	1.376	1.165	1.860	1.599
Berat	5	2	6	2	33	28	48	40
Dibër	2	1	3	1	22	7	31	10
Durrës	9	7	10	12	114	78	173	132
Elbasan	4	7	4	8	57	41	68	49
Fier	9	3	9	3	118	65	165	89
Gjirokastrë	6	5	8	6	86	78	117	130
Korçë	6	5	8	5	59	57	66	75
Kukës	2	2	2	5	49	50	72	79
Lezhë	9	13	14	14	168	149	285	245
Shkodër	3	3	3	3	26	26	33	37
Tiranë	64	51	67	54	627	541	769	650
Vlorë	0	6	0	7	17	45	33	63

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Metodologjia

Qëllimi i publikimit mujor të aksidenteve rrugore është paraqitja e rezultateve dhe treguesve mbi aksidentet rrugore si: ndryshimi në numrin e aksidenteve mujore, numrit të personave të vrarë dhe të plagosur nga aksidentet rrugore të klasifikuar sipas gjinisë, sjelljes së përdoruesve të rrugës, moshës dhe qarqeve në vend duke e krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është institucioni i cili i siguron INSTAT-it një sistem të gjerë informacioni lidhur me aksidentet rrugore.

Përkufizime

Aksidente: Ngjarje e papritur, e padëshiruar ose e paqëllimshme ose një zinxhir specifik ngjarjesh të tilla që sjellin pasoja të dëmshme.

Aksident me pasoja: Çdo aksident që përfshin të paktën një automjet rrugor në lëvizje në një rrugë publike ose private në të cilën publiku ka të drejtë hyrjeje, duke rezultuar në të paktën një person të plagosur ose të vrarë.

I vdekur: Çdo person i cili ka vdekur menjëherë ose brenda 30 ditëve si rezultat i aksidentit, përjashtuar vetëvrasjet.

I plagosur: Çdo person i cili si rezultat i një aksidenti nuk u vra menjëherë ose nuk vdiq brenda 30 ditësh, por pësoi një dëmtim për të cilin lind nevoja e një trajtimi mjekësor, duke përjashtuar vetëvrasjet në përpjekje.

Sjellja e Drejtuesit të Mjetit: Nënkupton aksidentet që ndodhin kur drejtuesi i mjetit nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas "Kodit Rrugor" si: frenim i papritur, mosrespektimi i shenjave (sinjalistikës) së trafikut, mosrespektimi i normave të shpejtësisë, etj.

Sjellja e Këmbësorëve: Nënkupton aksidentet që ndodhin kur këmbësori nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas "Kodit Rrugor" si: kalim rruge pa kujdes, etj.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme/Drejtoria e Policisë së Shtetit.

Të dhënat e muajit të fundit mbi Personat e vdekur nga aksidentet rrugore janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë, referohu: [Politika e Revizionimit Statistikor](#).

Shpjegimi i simboleve

- 0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse
- pa vlerë
- (...) mungesë të dhënash